



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



## **Raport Konsultativ**

**Shqyrtimi i njëmbëdhjetë i tarifave të energjisë elektrike**

**SHTTE11 (2017-2018)**

**Llogaritja e të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) të OST/OT (Viti Relevant 5)**

### **DEKLARATË**

**Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga ZRRE me qëllim të informimit të palëve të interesit.**  
**Raporti nuk paraqet Vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të konsiderohet si i tillë.**

**Shkurt 2017**



## **Përmbajtja**

<b>1</b>	<b>Përmbledhje.....</b>	<b>2</b>
<b>2</b>	<b>Përshtatja e të Hyrave të Lejuara Maksimale.....</b>	<b>3</b>
<b>3</b>	<b>Bilanci i Energjisë.....</b>	<b>3</b>
3.1	Realizimi dhe Parashikimi i Bilancit të Energjisë Elektrike në OST.....	4
<b>4</b>	<b>Propozimi për të Hyrat e Lejuara Maksimale të KOSTT.....</b>	<b>5</b>
4.1	Kostot e Lejuara të Operimit dhe Mirëmbajtjes (OPMct).....	5
4.2	Zhvlerësimi i Lejuar (DEPct).....	6
4.3	Kthimi i Lejuar në Kapital (RTNct).....	6
4.4	Kostot e Lejuara të Shërbimeve Ndhmëse (ASVct).....	7
4.5	Kostoja e Lejuar e Humbjeve (LSSct).....	7
4.6	Të Hyrat e Lejuara për Mekanizmin Kompenzues ndër-OST (ITCRt).....	9
4.7	Faktori i Përshtatjes së të Hyrave (KREvt).....	9
4.8	Të Hyrat e Lejuara Maksimale të KOSTT.....	10



## 1 Përmbledhje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aktualisht është duke kryer Përshtatjen e Rregullt dhe procesin e Azhurnimit Vjetor për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) që do të mbulohen nga Kompanitë e Rregulluara. Në këtë proces, ZRRE-ja do të aprovojë MAR të azhurnuar për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT, KOSTT), Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH, KEDS) dhe Furnizuesin me Shërbime Universale të Energjisë Elektrike (FSHU), bazuar në propozimet e dorëzuara nga Kompanitë e Rregulluara. Këto më pas do të përdoren nga Kompanitë e Rregulluara për të propozuar tarifat e tyre për këtë vit që do të jenë efektive nga data 1 prill 2017.

Vlerat bazë për komponentët e MAR janë përcaktuar në Shqyrtimin Periodik të bërë në vitin 2012 dhe mbesin të vlefshme për një periudhë shumëvjeçare. Shqyrtimi aktual ka të bëjë me vlerësimin e propozimeve për MAR të paraqitura nga Kompanitë e Rregulluara dhe përshtatjen e tyre me vlerat bazë. Ky shqyrtim vlerëson nëse propozimet e të licencuarve janë llogaritur saktë në përputhje me kërkesat ligjore.

Në korrik të vitit 2016, Parlamenti i Republikës së Kosovës, ka miratuar Ligjet e reja për sektorin e energjisë, të cilat kanë sjellë ndryshime esenciale në rregullimin e sektorit. Ky është viti i parë që ZRRE ndërmerr një Shqyrtim Tarifor me ligjet e reja në fuqi për sektorin e energjisë në Kosovë dhe rrethanat e reja të krijuara me ndryshimet ligjore, do të jenë mjaft sfiduese për ZRRE-në dhe të gjithë akterët. Prandaj ZRRE fton kompanitë e rregulluara, konsumatorët dhe të gjitha palët tjera të interesit, që të japin kontributin e tyre në këtë proces, duke shqyrtuar dhe komentuar të dhënat dhe pikëpamjet e paraqitura në këtë Raport Konsulativ, në mënyrë që vlerësimi të jetë i saktë për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Transmetimit.

Palët të cilat dëshirojnë të shprehin mendimet rreth qëndrimit të ZRRE-së ftohen që të dorëzojnë komentet e tyre me shkrim në postën elektronike [ero.pricing-tariffs@ero-ks.org](mailto:ero.pricing-tariffs@ero-ks.org) jo më vonë se **14 mars 2017**. Gjithashtu, komentet mund të dërgohen me postë në:

Zyra e Rregullatorit për Energji  
Departamenti për Tarifa dhe Çmime  
Rr. Dervish Rozhaja Nr. 12, Prishtinë, 10000, Kosovë

### Documentet relevante

Vlerësimi fillestar i ZRRE-së të formularëve të raportimit të OST/OT të dorëzuara në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik	<a href="http://ero-ks.org/Price%20and%20Tariffs/2012/albanian/Vleresimi_fillestar_per_KOSTT_shqip.pdf">http://ero-ks.org/Price%20and%20Tariffs/2012/albanian/Vleresimi_fillestar_per_KOSTT_shqip.pdf</a>
Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së të MAR të OST/OT në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik – Vlerësim i detajuar	<a href="http://ero-ks.org/Tarifat/2012/Vleresimi_i_perkohshem_KOSTT.pdf">http://ero-ks.org/Tarifat/2012/Vleresimi_i_perkohshem_KOSTT.pdf</a>
Vlerësimi përfundimtar i MAR të OST/OT në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik – Vlerësim i detajuar	<a href="http://ero-ks.org/Tarifat/2013/Proceset%20e%20Shqyrtimit/Vleresimi_perfundimtar_KOSTT_Shq_22_Mars_2013.pdf">http://ero-ks.org/Tarifat/2013/Proceset%20e%20Shqyrtimit/Vleresimi_perfundimtar_KOSTT_Shq_22_Mars_2013.pdf</a>



## 2 Përshtatja e të Hyrave të Lejuara Maksimale

ZRRE, bazuar në Rregullën për Vendosjen e Çmimeve për OST/OT, ka analizuar me kujdes të gjitha komponentet e kostove dhe kërkesat e të licencuarit të paraqitura në aplikacionet e tyre për të Hyrat e Lejuara Maksimale. Gjatë procesit të Përshtatjes së Rregullt, ZRRE përdor vlerat e marra gjatë procesit të Shqyrtimit Periodik në SHTE7 dhe përshtat MAR-in për të reflektuar ndryshimet në mes të kostove që kanë qenë të parashikuara gjatë Shqyrtimit Periodik dhe kostove aktuale të shkaktuara nga Kompanitë e Rregulluara për shkak të arsyeve që janë jashtë kontrollit të tyre. Gjatë këtij procesi ZRRE do të:

1. Indeksjojë Kostot Operative dhe të Mirëmbajtjes për Faktorin e Efikasitetit i cili caktohet gjatë procesit të Shqyrtimit Periodik dhe për Inflacionin Vjetor i cili caktohet duke përdorur Indekset e Harmonizuara të Çmimeve të Konsumit (HICP) për vendet e Eurozonës;
2. Caktojë Kostot e Lejuara të Humbjeve (LSSct) për OST, dhe t'i azhurnojë këto në mënyrë që të përfshijnë ndryshimin në mes të kostove të lejuara dhe të realizuara të humbjeve për Periudhën paraprake Rregullative, të cilat mund të kenë ndodhur si rezultat i ndryshimeve në kostot e blerjes së energjisë me shumicë apo i ndryshimeve në rrjedhat e energjisë elektrike në sistemin e Transmetimit;
3. Azhurnojë MAR-in e OST/OT-së në mënyrë që të reflektojë ndryshimin në mes të të Hyrave të Lejuara dhe të Realizuara në Vitin paraprak Relevant (t-1);
4. Azhurnojë parashikimet e kostove të lejuara të shërbimeve ndihmëse
5. Caktojë MAR-in e OST/OT-së për Vitin Relevant t.

## 3 Bilanci i Energjisë

Vitet e kaluara ZRRE-ja ka përdorur parashikimin e bilancit të energjisë të aprovuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) për Vitin Relevant t për të llogaritur MAR të KOSTT-it.

Duke filluar nga ky vit relevant tarifor, ZRRE do të përdorë bilancin e aprovuar nga Bordi i ZRRE-së, me qëllim të kalkulimit të të Hyrave të Lejuara të OST/OT-së, ndërsa për përshtatjet e vitit paraprak do të përdoret bilanci i realizuar i energjisë të siguruar nga KOSTT.

Bilanci i aprovuar nga ZRRE gjithashtu do të përdoret për të llogaritur blerjet e energjisë me shumicë për mbulimin e humbjeve të transmetimit, shpërndarjes dhe tarifën me pakicë për Shërbimin Universal.



### 3.1 Realizimi dhe Parashikimi i Bilancit të Energjisë Elektrike në OST

Sa i përket bilancit të parashikuar për vitin 2017, ZRRE ka marrë parasysh nivelin e planifikuar të sasisë së energjisë në rrjetin e transmetimit dhe pastaj ka aplikuar cakun e humbjeve për të kalkuluar energjinë e nevojshme për OST-në.

Bilanci i energjisë së parashikuar për vitin 2017 është përgatitur si në vijim:

- Kërkesa për energji elektrike të konsumatorëve të kyqur në nivel të transmetimit dhe shpërndarjes;
- Prodhimi i energjisë elektrike nga gjenerimi vendor dhe importi;
- Furnizimet e pa faturuara në Veriun e Kosovës gjithashtu janë parashikuar duke përdorur projeksionet e ofruara nga KESCO. Në bilancin e aprovuar nga ZRRE, këto furnizime të pa faturuara pritet të jenë 246 GWh energji elektrike;
- Humbjet në rrjetin e transmetimit janë bazuar në parashikimin e KOSTT në nivelin prej 1.75%;
- Eksportet pastaj përshtaten në mënyrë që të sigurojnë se volumet e energjisë së projektuar hyrëse dhe dalëse në sistem janë në bilancë (pas lejimit për humbje të energjisë).

Analiza e bilancit të realizuar për vitin 2016 dhe atij të parashikuar për vitin 2017 është paraqitur në tabelën në vijim:

Bilanci i energjisë elektrike ne OST	Njësia	SHTE 10 Realizimi	SHTE 11 Propozimi
Hyrja ne OST	GWh	6,476.0	6,389.5
Energjia e pafaturuar në Veri	GWh	251.9	246.0
Eksporti	GWh	1,064.2	1,382.1
Importi	GWh	458.8	250.0
<hr/>			
Humbjet në OST	GWh	120.5	111.8
	%	1.86%	1.75%
<hr/>			
<b>Dalja e energjisë nga Transmetimi/hyrja në në OSSH</b>	<b>GWh</b>	<b>4,484.9</b>	<b>4,108.3</b>



## 4 Propozimi për të Hyrat e Lejuara Maksimale të KOSTT

Me qëllim të vlerësimit të të Hyrave të Lejuara Maksimale për OST/OT, ZRRE ka analizuar me kujdes secilin element të kostos. Vlerësimi i tyre është bërë duke u bazuar në Rregullën për Përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale të OST/OT-së (Shtojca 1).

MAR llogaritet çdo vit sipas formulës në vijim:

$$MAR_t = OPMC_t + DEPC_t + RTNC_t + ACVC_t + LSSC_t + LICC_t - ITCR_t + KREV_t$$

Ku:

$MAR_t$  janë të hyrat e lejuara maksimale në vitin relevant  $t$

$OPMC_t$  janë kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant  $t$

$DEPC_t$  është zhvlerësimi i lejuar në vitin relevant  $t$

$RTNC_t$  është kthimi i lejuar në kapital në vitin relevant  $t$

$ASVC_t$  është kostoja e lejuar për shërbime ndihmëse në vitin relevant  $t$

$LSSC_t$  është kostoja e lejuar e humbjeve në vitin relevant  $t$

$LICC_t$  është kostoja e taksës për licencë në vitin relevant  $t$

$ITCR_t$  janë të hyrat neto të OST/OT nga mekanizma kompensues ndër-OST në vitin relevant  $t$

$KREV_t$  është faktori i korrigjimit të të hyrave në vitin relevant  $t$

Llogaritja e secilit nga këta komponentë është shtjelluar më poshtë.

### 4.1 Kostot e Lejuara të Operimit dhe Mirëmbajtjes (OPM<sub>Ct</sub>)

Kostot operative dhe të mirëmbajtjes për OST/OT janë përcaktuar me Shqyrtimin Periodik dhe tani çdo vit tarifor ato përshtaten për inflacion dhe faktorin e efikasitetit.

Përcaktimi i kostove Operative dhe të Mirëmbajtjes është bërë duke përdorur formulën e mëposhtme::

$$OPM_{Ct} = OPM_{Ct-1} * (CPI_{t-1}) * OPM_{Cft}$$

Ku

$OPM_{Ct}$  janë kostot e lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes në vitin relevant  $t$

$OPM_{Ct-1}$  janë kostot e lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes në vitin relevant  $t-1$

$CPI_{t-1}$  është vlera e realizuar e inflacionit në vitin relevant  $t-1$ , e matur duke përdorur "Indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumatorëve



*(HICP-të) – të gjitha njësitë në Eurozonë” të publikuara nga Eurostat-i, apo ndonjë vlerësim tjetër i inflacionit që rregullatori e përcakton të jetë si masa më e mirë e ndryshimit në kostot operative dhe të mirëmbajtjes përgjatë kohës dhe që është e lejuar gjatë shqyrtimit periodik*

*OPMC<sub>ft</sub> janë kostot e lejuara të parashikuara të operimit dhe mirëmbajtjes në vitin relevant t, të cilat janë caktuar gjatë shqyrtimit periodik. Kjo tanimë përfshinë përshtatjet për përmirësimet e supozuara në efikasitet*

ZRRE-ja ka aplikuar faktorin e efikasitetit prej 4% siç është përcaktuar në Shqyrtimin Periodik për vitin 2017. Norma e aplikuar e inflacionit është 0.2% dhe është llogaritur nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumatorëve për vendet e Eurozones.

Niveli i lejuar i kostove të operimit dhe mirëmbajtjes për SHTE11, 2017 pas aplikimit të faktorëve të sipërpërmendur ka rezultuar të jetë 6.5 milion €.

#### **4.2 Zhvlerësimi i Lejuar (DEPCt)**

Rregulla për vendosjen e Çmimeve prapë supozon se zhvlerësimet e lejuara zbuten dhe profilizohen gjatë Periudhës Rregullative. Pasi që asnjë zbutje nuk është aplikuar në praktikë, ZRRE-ja ka përdorur formulën e përshtatjes si në vijim, e cila është e njëjtë me formulën e miratuar në vitet e mëparshme:

$$DEPC_t = DEPC_{t-1} * (CPI_{t-1}) + DEPC_{ft}$$

*Ku:*

*DEPC<sub>t</sub> është zhvlerësimi tjetër i lejuar në vitin relevant t*

*DEPC<sub>t-1</sub> është zhvlerësimi i lejuar në vitin relevant t-1*

*CPI<sub>t-1</sub> është vlera e realizuar e inflacionit në vitin relevant t-1, e matur duke përdorur “Indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – të gjitha njësitë, për Eurozonën” publikuar nga Eurostat-i*

*DEPC<sub>ft</sub> është zhvlerësimi i lejuar i parashikuar në vitin relevant t, i cili përcaktohet në shqyrtimet periodike*

Zhvlerësimi i lejuar për SHTE11 është caktuar të jetë 7.6 milion €.

#### **4.3 Kthimi i Lejuar në Kapital (RTNCt)**

Ashtu si në llogaritjen e komponentëve të OPMct dhe DEPCt, ZRRE-ja nuk ka profilizuar ose zbutur kthimin e lejuar në kapital gjatë Shqyrtimit Periodik. Prandaj, kjo komponentë është llogaritur me formulën e mëposhtme:

$$RTNC_t = RTNC_{t-1} * (CPI_{t-1}) + RTNC_{ft}$$



*Ku:*

$RTNC_t$  është kthimi i lejuar në kapital në vitin relevant  $t$

$RTNC_{t-1}$  është kthimi i lejuar në kapital në vitin relevant  $t-1$

$CPI_{t-1}$  është vlera e realizuar e inflacionit në vitin relevant  $t-1$ , e matur duke përdorur "Indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – të gjitha njësitë, për Eurozonën" publikuar nga Eurostat-i

$RTNC_{ft}$  është kthimi i lejuar në kapital i parashikuar në vitin relevant  $t$ , i cili përcaktohet në shqyrtimet periodike

Kthimi i lejuar në kapital për OST/OT për SHTE11 është caktuar të jetë 3.9 milion €.

#### 4.4 Kostot e Lejuara të Shërbimeve Ndhmëse (ASVCT)

Në SHTE9 KOSTT-it i janë lejuar blerjet e rezervave sekondare dhe terciare për operimin si një zonë rregulluese e ndarë (sipas rregullave ENTSO-E<sup>1</sup>) që nga qershori i vitit 2015, edhe pse këto kosto nuk janë realizuar gjatë viteve 2015-2016. Për arsye të mosrealizimit të këtyre kostove në shqyrtimet e viteve paraprake ZRRE ka zbritur ato. Sidoqoftë edhe në këtë shqyrtim tarifor KOSTT-it i është lejuar sasia e njejtë prej 3.9 milion € bazuar në kërkesën e tyre.

#### 4.5 Kostoja e Lejuar e Humbjeve (LSSCt)

Me qëllim të vlerësimit të kostove që kanë të bëjnë me blerjen e humbjeve në nivel të OST/OT-së, ZRRE ka analizuar të dhënat e raportuara nga KOSTT për vitin 2016 dhe të dhënat për parashikimin e bilancit për vitin 2017.

Kostoja e Lejuar e Humbjeve për OST përcaktohet gjatë secilës Përshtatje të Rregullt përmes formulës së mëposhtme (Shtojca 1 paragrafi 2.4 i Rregullës për Çmimet e OST/OT):

$$LSSC_t = LSSA_t * REUE_t * WHEA_t + (LSSCa_{t-1} - LSSCf_{t-1}) * (1 + I_t) + (LSSCa_{t-1} - LSAC_{t-1}) * LSSF_t$$

*Ku*

$LSSC_t$  është kostoja e lejuar e humbjeve për vitin relevant  $t$

---

<sup>1</sup> ENTSO-E është Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energji Elektrike (ekziston edhe një rrjet paralel për OST-të e gazit natyror). Sipas rregullave të ENTSO-E, secili vend ka një OST të ndarë dhe operon si fushë e ndarë kontrolli për qëllime të kontrollit të sistemit të transmisionit të energjisë elektrike. Kjo në vete sjellë një numër obligimesh siç janë sigurimi i dispozitave të duhura të shërbimeve ndihmëse nga resurset që janë me vendndodhje brenda apo të kontraktuara për atë zonë. Deri më sot, për shkak të dështimit të arritjes së marrëveshjes për statusin në mes të Serbisë dhe Kosovës, ENTSO-E e ka konsideruar Kosovën të jetë e kombinuar me Serbinë për këtë qëllim. Si pjesë e bisedimeve të vazhdueshme për statusin, Serbia është pajtuar që të njohë Kosovën si pjesë të ndarë të kontrolluar KOSTT për qëllime të ENTSO-E por kjo nuk është zbatuar ende.





$LSSA_t$	<i>janë humbjet e lejuara, që janë paraqitur si përqindje e energjisë që hyn në sistemin e transmisionit në vitin relevant t</i>
$REUE_t$	<i>janë njësitë e energjisë (MWh) që hyjnë në sistemin e transmisionit në vitin relevant t</i>
$WHEA_t$	<i>është mesatarja e kostos me shumicë të energjisë (€/MWh) siç është e përcaktuar duke përdorur kostot e lejuara me shumicë për FPEE në vitin relevant t</i>
$LSSCa_{t-1}$	<i>është kostoja e realizuar e humbjeve të lejuara në vitin relevant t-1, (llogaritur duke përdorur humbjet e lejuara)</i>
$LSSCf_{t-1}$	<i>është kostoja e parashikuar e humbjeve në vitin relevant t-1, (llogaritur duke përdorur humbjet e lejuara)</i>
$I_t$	<i>është norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus 5%, ku S paraqet vlerën që do përcaktohet nga Rregullatori gjatë shqyrtimeve periodike që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për huatë afatshkurtra mbi normën e EURIBOR-it</i>
$LSAC_{t-1}$	<i>është kostoja e humbjeve të realizuara nga OST gjatë blerjes së energjisë nga FPEE si kompensim i energjisë së humbur në rrjetin e shpërndarjes në vitin relevant t (nuk llogaritet duke përdorur humbjet e lejuara)</i>
$LSSF_t$	<i>është faktori i ndarjes së humbjeve në vitin relevant t, që caktohet gjatë shqyrtimeve periodike.</i>

Norma e interesit e përdorur për të llogaritur kompensimin në mes të kostove të realizuara dhe të lejuara në vitin paraprak relevant është llogaritur duke përdorur preminë-S të caktuar nga ZRRE-ja gjatë Shqyrtimit Periodik (15%) plus normën vjetore të EURIBOR (-0.1%<sup>2</sup>). Prandaj, norma e interesit për përshtatje është 14.9%. Faktori i Ndarjes së Humbjeve në Vitin Relevant t është caktuar në 100%. Niveli i lejuar i humbjeve për sistemin e transmetimit sipas SHTE11 është 1.75%. Llogaritja është e përmbledhur në tabelën në vijim.

---

<sup>2</sup> Norma Euribor për 10 shkurt 2017 <http://www.euribor-rates.eu/euribor-rate-12-months.asp>



**Tabela 1 Llogaritja e Kostove të Lejuara të Humbjeve të OST**

Kostoja e Lejuar e Humbjeve për OST		SHTE10 (2016) Lejuar	SHTE10 (2016) Realizuar	SHTE11 (2017) Propozuar
<b>Parametrat e indeksimit</b>				
Faktori i ndarjes së humbjeve	%	50.00%	50.00%	50.00%
Euribor	%	-0.13%	-0.10%	-0.10%
S-faktori	%	15.00%	15.00%	15.00%
It	%	14.87%	14.90%	14.90%
<b>Humbjet e Lejuara (LSSCt)</b>				
LSSAt	%	1.80%	1.86%	1.75%
REUEt	GWh	6,331.8	6,476.0	6,389.5
WHEAt	€/MWh	34.1	34.1	35.4
LSSCat-1	€m		4.0	
LSSCft-1	€m	3.9		
LSACT-1	€m		4.1	
LSSCt	€m	3.9		3.9

Kostoja e humbjeve për KOSTT në kuadër të SHTE11 është 3.9 milion €.

#### 4.6 Të Hyrat e Lejuara për Mekanizmin Kompensues ndër-OST (ITCRt)

Duhet theksuar që KOSTT nga data 01.01.2016 është pjesë e ITC mekanizmit dhe kjo i mundëson KOSTT që të realizojë të hyra sipas mekanizmit ITC sipas rregullave të ENTSO-E. Në vitin 2016 KOSTT paraqitet net-pozitiv me 144,132 €. Të hyrat e realizuara nga tranziti janë 335,336 € kurse shpenzimet për tranzit janë 191,204 €.

Për vitin 2017 parashikimi për ITC është: Të hyrat 340,000 €, Shpenzimet 240,000 €, te hyrat neto nga ITC mekanizmi për vitin relevant tarifor 2017 parashihen të jenë 100,000 €.

#### 4.7 Faktori i Përshtatjes së të Hyrave (KREVT)

Kostot e KOSTT-it janë në masë të madhe fikse por të hyrat varen nga volumi i transmetuar në kërkesën e pikut. Për të korigjuar këtë mospërputhje, KOSTT-it i lejohet që të mbuloj ndryshimin në mes të të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) nga ZRRE për Vitin Relevant t dhe të Hyrat e Realizuara (ARR) gjatë periudhës t-1. Formula për këtë përshtatje është e treguar më poshtë:

$$KREV_t = (MAR_{t-1} - ARR_{t-1}) * (1 + I_t)$$

*Ku*

*ARRt-1* janë të hyrat e rregulluara të realizuara në vitin relevant t-1

*MARt-1* janë të hyrat e lejuara maksimale siç janë të përcaktuar për vitin relevant t-1



*It është norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus S%, ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga Rregullatori gjatë shqyrtimeve periodike që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për huatë afatshkurtra mbi normën e EURIBOR-it*

Ndryshimi në mes të MAR të lejuar nga ZRRE-ja prej 22.4 milion € dhe të ARR të mbledhura nga OST/OT prej 23.9 milion € i kthehet konsumatorëve dhe zbriten nga MAR i OST/OT me përshtatje për normën e interesit.

#### **4.8 Të Hyrat e Lejuara Maksimale të KOSTT**

MAR për KOSTT për vitin 2017 propozohet të jetë 34.92 milion €, e cila paraqet një rritje të theksuar në raport me vlerën prej 22.4 milion € sa ishte në vitin 2016. Kjo rritje vjen si rezultat i ndryshimeve ligjore në aspektin e rregullimit të sektorit të energjisë në Kosovë.

Duke filluar nga data 1 prill i vitit 2017, KOSTT do të jetë përgjegjës për trajtimin e energjisë nga Burimet e Ripërtëritshme dhe menaxhimin e Fondit për BRE në vlerë prej 6.7 milion €, shumë kjo e cila do të menaxhohet nga Operatori i Tregut në kuadër të KOSTT-it.

Një rritje e MAR-it të KOSTT-it për vitin 2017 i atribuohet koston së humbjeve në Veri të Kosovës të cilat për vitin 2017 janë parashikuar të jenë në vlerë prej 8.7 milion €.

Përshtatjet negative në MAR-in e KOSTT-it i atribuohen kryesisht kthimit të parave për lejimin e kostove të shërbimeve ndihmëse të lejuara në vitin 2016 e cila nuk është përdorur (ekuivalent me zbritjen në MAR për 2017 prej 4.4 milion € pas përshtatjes së normës së interesit të aplikuar), , kontributet e konsumatorëve në vlerë prej 0.7 milion € dhe të hyrat neto nga ICT për vitin 2016 dhe 2017 në vlerë prej 0.2 milion €.

Tabela në vazhdim paraqet propozimin për të Hyrat e Lejuara Maksimale për OST/OT në kuadër të SHTE11:



**Tabela 2 Propozimi i MAR të KOSTT**

MAR i KOSTT		SHTE10 E lejuar	SHTE10 E realizuar	SHTE11 E propozuar
<b>Parametrat e indeksimit</b>				
Faktori I efikasitetit	%	4.00%	4.00%	4.00%
Faktori profilizues		0.00	0.00	0.00
Inflacioni	%	0.43%	0.2%	0.2%
Euribori	%	0.25%	-0.13%	-0.1%
S-factor	%	15.00%	15.00%	15.00%
Norma e interesit	%	15.25%	14.9%	14.9%
<b>Kosto operative dhe e mirëmbajtjes (OPMct)</b>				
$OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$	€m	6.66		6.47
<b>Zhvelrësimi I lejuar (DEPCt)</b>				
$DEPC_t = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	6.97		7.64
<b>Kthimi I lejuar (RTNCt)</b>				
$RTNC_t = RTNC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	3.26		3.95
<b>Shërbimet ndihmëse</b>				
Shërbimet ndihmëse	€m	-0.57	0	-0.58
<b>Fondi për BRE</b>				
Fondi për BRE	€m			6.67
<b>Humbjet në Veri</b>				
Humbjet në Veri	€m			8.71
<b>Humbjet e lejuara (LSSCt)</b>				
LSSAt	%	1.80%	1.86%	1.75%
REUEt	GWh	6,331.8	6,476.0	6,389.5
WHEAt	€/MWh	34.1	34.1	35.43
LSSCat-1	€m		4.0	
LSSCft-1	€m	3.89		4.0
LSACT-1	€m		4.1	
LSSCt	€m	3.89		3.92
<b>KREV (përfshirë azhurnimet)</b>				
	€m	2.17		-1.75
<b>MAR i KOSTT</b>				
Gjithsejtë të Hyrat e Lejuara Maksimale	€m	22.37	23.90	34.92